



PPP.nr. 765/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve Arbian Bytyqi nga fshati Nishor, Komuna e Suharekes dhe Kosovare Bytyqi, të iclet me autorizim i përfaqëson Halil Kurmehaj nga Prishtina, me adrese Ulpiana, C-4, 3/2, kundër debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me përmbartimin e kërkesës në të holla- borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar me datë 20.10.2014 nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit numër P.nr.708/14 datë 10.10.2014, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku, në Prishtinë, jashtë seancës, me dt. 25.01.2017, mori këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe **ANULOHET** Urdhri Përmbartimor P.nr.708/14 me dt.10.10.2014, i përmbartuesit Afet Mjeku.

Arsyetim

Përmbartuesi privat, Afet Mjeku në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorëve ka lëshuar Urdhrit përmbartimor P.nr.708/14, dt.10.10.2014, me të cilin ka lejuar përmbartimin në baze të aktvendimit të debitorit dt.15.01.2014, për kompensim për personat e verbër, për secilin veç e veç në shume prej nga 100 €.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim është theksuar se zyra përmbartimore në fjalë ka lejuar përmbartimin duke shkelur dispozitat thelbësore procedurale Gjithashtu ka theksuar se nuk është bere llogaritja e diferencës së shumës që kreditorët kanë realizuar, me diferencën e shumës që ju është njohur kompensimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për këto arsye:

Gjykata vlerëson se debitori me aktvendimin e dt.15.01.2014, kreditorëve ua ka njohur kompensimin për të verbër në shume mujore nga 100 €, për secilin veç e veç, për periudhën prej dt.01.01.2013 deri me 01.01.2014. Gjykata vlerëson se aktvendimi nuk është pajisur me vërtetim të plotfuqishmërisë dhe me vërtetim të përmbartueshmerisë, ndërsa përmbartuesi privat para lejimit të përmbartimit nuk ju ka kërkuar kreditorëve që aktvendimi të pajiset me këto vërtetime dhe nuk ka vërtetuar faktin se cila pjesë e kompensimit është paguar e cila pjesë e kompensimit të mbetur me u paguar me ekspertë financiar.

Në rastin konkret kjo gjykate vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e Urdhrit përmbartimor nga ana e përmbartuesit, sepse aktvendimi i marre në procedure administrative nuk ka vërtetim për përmbartueshmeri, në kuptim të nenit 36. Par 1 të LPP-se, sikundër nuk është vërtetuar se debitori a ka paguar ndonjë shume të kreditorëve, nëse ka paguar atëherë duhet të vërtetohet se cila pjesë ka mbetur pa paguar. Kështu kjo gjykate vendosi të anuloi Urdhrit përmbartimor duke pranuar prapësimin e debitorit

Për këtë arsye u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit e duke zbatuar nenin 73.3 te LPP-se.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PPP.nr. 765/16 date 25.01.2017

KESHILLE JURIDIKE: është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

